

L I G J
Nr.7806, datë 17.3.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7574, DATË 24.6.1992 “PËR ORGANIZIMIN E DREJTËSISË DHE DISA NDRYSHIME NË KODET E PROCEDURAVE PENALE E CIVILE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 3

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7574, datë 24.6.1992 “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile”, neni 2 ndryshohet si vijon:

“Gjykata e Apelit dhe Gjykata Ushtarake e Apelit funksionojnë në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ato përbëhen nga kryetari, zëvendëskryetarët dhe gjyqtarët. Gjykata e Apelit shqyrton ankimet dhe protestat kundër vendimeve penale e civile të gjykatave të shkallës së parë. Ajo gjykon me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë”.

Neni 2

Paragrafi i parë i nenit 4 ndryshohet si vijon:

“Gjykata e Apelit, pasi administron provat e çështjes, vendos:

1. Lënien në fuqi të vendimit.
2. Ndryshimin e vendimit.
3. Prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes ose të gjykimit, kur janë rastet e parashikuara nga kodet e procedurave penale e civile.
4. Prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim nga një trup gjykues tjetër, kur janë shkaqet e parashikuara nga paragrafi i dytë i nenit 173 të Kodit të Procedurës Penale dhe paragrafi i dytë i nenit 171 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në raste të veçanta, kur nuk janë marrë prova vendimtare për zgjidhjen e drejtë të çështjes, marrja e të cilave është e vështirë të bëhet në Gjykatën e Apelit”.

Neni 3

Paragrafi i parë i nenit 5 ndryshohet si vijon:

“Gjykatat ushtarake të shkallës së parë gjykojnë ushtarakët për veprat penale të kryera prej tyre, robërit e luftës dhe persona të tjerë të caktuar me ligj. Ato përbëhen nga kryetari, zëvendëskryetarët, gjyqtarët dhe ndihmësgjyqtarët”.

Fjalja e fundit e paragrafit të dytë të nenit 5 shfuqizohet.

Neni 4

Neni 10 ndryshohet si vijon:

“Ministri i Drejtësisë, në raste të veçanta, mund të urdhërojë një gjyqtar të gjykatës së rrethit ose ushtarake për të gjykuar në një gjykatë tjetër rrethi ose ushtarake”.

Neni 5

Neni 8 shfuqizohet.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.806, datë 1.4.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.